KËRKESË
Nr.2075, datë 19.3.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i rehabilitimit dhe zgjerimit të fushës së mbetjeve urbane të qytetit të Tiranës, në fshatin Sharrë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është komuna Vaqarr. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësmit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë komunës Vaqarr (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 275 269 (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI DHE ZGJERIMI I FUSHËS SË MBETJEVE URBANE TË QYTETIT TË TIRANËS NË FSHATIN SHARRË

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas	Sip tokë/arë	Çmimi	Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1.	Haki	Fadil	Vladi	3321	138/1	162	537	86994	86994	Konfirmim ZRPP
2.	Qazim	Dervish	Vladi	3321	139/10	3530	537	1895610	1895610	Konfirmim ZRPP
3.	Nezir	Beqir	Muca	3321	146/7	225	537	120825	120825	Konfirmim ZRPP
4.	Qamil	Beqir	Muca	3321	146/8	225	537	120825	120825	Konfirmim ZRPP
5.	Bajram	Beqir	Muca	3321	146/9	95	537	51015	51015	Konfirmim ZRPP
		Totali				**4237**		**2275269**	**2275269**	